

IRLANDE



An Roinn Dlí agus Cirt,
Gnóthaí Baile agus Imirce
Department of Justice,
Home Affairs and Migration



ÇFARË DUHET TË DINI RRETH PROCEDURËS NË KUFI PËR AZILIN TË BE-së



ALBANIAN

Tani ndodheni në Irlandë i cili është një shtet i BE+.

Vendet e BE+ janë:



27 shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (BE): Austria, Belgjika, Bullgaria, Çekia, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Greqia, Gjermania, Holanda, Hungaria, Italia, Kroacia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Polonia, Portugalia, Qipro, Republika e Irlandës, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia dhe



4 vende të tjera: Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia dhe Zvicra.



PËRMBAJTJA

Çfarë është mbrojtja ndërkombëtare (azili)?	3
Çfarë është procedura e azilit?	4
➤ Çfarë është procedura në kufi për azilin?	6
➤ Sa do të zgjasë?	7
➤ Kur dhe ku do të bëhet regjistrimi dhe depozitimi i kërkesës suaj?	8
➤ Çfarë do të ndodhë gjatë regjistrimit dhe depozitimit?	9
➤ Cila është procedura nëse keni mbërritur me një fëmijë ose me një të rritur në varësi?	12
➤ Cili shtet do ta shqyrtojë kërkesën tuaj?	13
➤ Si do të shqyrtohet kërkesa juaj?	
➤ ekzaminim mjekësor	16
➤ Si do t'i marrin parasysh autoritetet nevojat e veçanta?	17
➤ Si do t'ju jepet vendimi lidhur me kërkesën tuaj për mbrojtje ndërkombëtare?	18
Cilat janë të drejtat tuaja?	19
Cilat janë detyrimet tuaja?	23
Cilat janë pasojat nëse nuk i përmbushni detyrimet tuaja?	27
Po nëse dëshironi të ktheheni në vendin tuaj?	29

➤ ÇFARË ËSHTË MBROJTJA NDËRKOMBËTARE?

Ju mund të keni nevojë për mbrojtje ndërkombëtare në rast se nuk mund të ktheheni në vendin tuaj për shkak të frikës së persekutimit ose përballjes me rrezikun real ndaj dëmtimeve të rënda. Për shembull, kjo nënkupton se jeta ose liria juaj do të ishte në rrezik dhe autoritetet e vendit tuaj nuk do t'ju mbronin nga rreziku me të cilin përballeni.

Është e drejta juaj të bëni kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare.

Në Evropë, mbrojtja ndërkombëtare është e formave të ndryshme: **status refugjati** ose **mbrojtje plotësuese**.


Mbrojtja ndërkombëtare quhet gjithashtu azil.



➤ ÇFARË ËSHTË PROCEDURA E AZILIT?

Gjatë procedurës së azilit, autoritetet do të vlerësojnë nëse keni nevojë për mbrojtje ndërkombëtare dhe, nëse po, cila lloj mbrojtjeje është e përshtatshme për ju. Në procedurë ju do të keni mundësinë të cilësoni të gjitha arsyet se përse u larguat nga shtëpia juaj dhe vendi juaj i origjinës. Informoni nëpunësit, duke u treguar të sinqertë, për të gjitha arsyet se përse u larguat nga vendi juaj.

Pasi të keni kërkuar mbrojtje ndërkombëtare, ju do të konsideroheni kërkues për mbrojtje ndërkombëtare.



Çdo informacion që ndani me autoritetet do të mbetet konfidencial. Ky informacion nuk do të ndahet në asnjë rast me personat nga të cilët po kërkon mbrojtje.

Procedura e azilit përfshin hapat e mëposhtëm.

Mbërritja në Evropë



1 Paraqitja e kërkesës



2 Regjistrimi i kërkesës



3 Paraqitja e kërkesës




Përcaktimi i shtetit të BE+ përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës

Transferimi i mundshëm në një shtet tjetër të BE+

4 Intervista personale



5 Njoftimi i vendimit



Shteti aktual

Një shtet tjetër i BE+

VENDIM POZITIV

Mbrojtje

Mundësia për apelim

Refuzim

VENDIM NEGATIV

➤ ÇFARË ËSHTË PROCEDURA NË KUFÏ PËR AZILIN?



Procedura kufitare e azilit do të thotë që, ndërsa kërkesa juaj është duke u shqyrtuar:

- nuk ju është dhënë leje e ligjshme për të hyrë në Shtet
- duhet të qëndroni në një Qendër Akomodimi IPAS.

Nëse keni mbërritur me familjen tuaj, mund të akomodoheni së bashku me anëtarët e rrethit të ngushtë familjar (bashkëshortin, partnerin, fëmijët e mitur dhe fëmijët në varësi të të rriturve).

Procedura në kufi për azilin mund të përdoret në një nga rrethanat e mëposhtme:



- keni mbërritur në mënyrë të parregullt dhe keni kërkuar mbrojtje ndërkombëtare në një pikë kalimi kufitar ose në një zonë transiti



- keni kaluar kufirin në mënyrë të parregullt



- jeni shpëtuar në det



- jeni zhvendosur këtu nga një shtet tjetër i BE+.

Procedura në kufi për azilin zbatohet për disa arsye, për shembull, nëse:

- keni paraqitur qëllimisht informacion ose dokumente të rreme, ose keni fshehur informacion apo dokumente me rëndësi në lidhje me identitetin ose kombësinë tuaj, ose keni shkatërruar një dokument identiteti apo udhëtimi; ose
- përbëni rrezik për sigurinë; ose
- njerëzit nga vendi juaj që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare zakonisht nuk janë në rrezik për persekutim ose lëndime serioze.

Ju mund t'i pyesni autoritetet se përse është zbatuar procedura në kufi për azilin në rastin tuaj.

➤ SA DO TË ZGJASË?



Procedura në kufi për azilin zgjat deri në 12 javë duke nisur nga dita e regjistrimit të kërkesës suaj. Nëse transferoheni në një shtet tjetër të BE+, procedura mund të zgjasë deri në 16 javë.

Nëse nuk merrni një vendim brenda kësaj periudhe, do t'ju lejohet të hyni në territorin e shtetit ku po shqyrtohet kërkesa juaj.

Në raste të jashtëzakonshme, ju mund të mos lejoheni gjithsesi të hyni në territor dhe të lëvizni lirshëm, edhe pse nuk keni marrë një vendim brenda 12 ose 16 javëve. Autoritetet do t'ju informojnë dhe do t'ju japin sqarime të mëtejshme nëse ky përjashtim vlen për rastin tuaj.

► WHEN AND WHERE WILL THE REGISTRATION AND LODGING OF YOUR APPLICATION TAKE PLACE?

Kërkesa juaj për mbrojtje ndërkombëtare do të regjistrohet në Qendrën e Shqyrtimit Citywest. Regjistrimi duhet të bëhet jo më vonë se 10 ditë nga data e aplikimit tuaj për Mbrojtje Ndërkombëtare.

Sapo të jetë regjistruar kërkesa juaj, do të duhet ta paraqisni atë në Qendrën e Shqyrtimit Citywest në datën dhe në kohën që do t'ju komunikohet gjatë regjistrimit.

Paraqitja e kërkesës suaj duhet të bëhet jo më vonë se 5 ditë nga data e regjistrimit të kërkesës suaj.

Është shumë e rëndësishme që të paraqisni kërkesën tuaj. Nëse nuk e paraqisni kërkesën tuaj, ajo do të konsiderohet e tërhequr, përveç nëse arsyeja për këtë dështim është përtej kontrollit tuaj. Kjo do të thotë që ju do të humbisni statusin tuaj si aplikant, të drejtën tuaj për mbështetje dhe shërbime dhe të drejtën për të qëndruar në këtë vend.



➤ ÇFARË DO TË NDODHË GJATË REGJISTRIMIT DHE DEPOZITIMIT?



Do t'ju merren gjurmët e gishtërinjve.



Do t'ju bëhet një fotografi.



Do t'ju kërkohet të paraqisni të gjitha dokumentet e identitetit, të udhëtimit dhe dokumente të tjera përkatëse.



Do t'ju kërkohet që të jepni të dhënat tuaja personale. Ju gjithashtu do të pyeteni për anëtarët e familjes suaj që banojnë në këtë shtet ose në një shtet tjetër të BE+.



Do t'ju kërkohet të jepni të dhënat tuaja të kontaktit (adresën, një numër telefoni dhe një adresë emaili).



Mund t'i nënshtroheni një kontrolli fizik, si dhe kontrollit të sendeve tuaja vetjake. Sendet tuaja vetjake mbeten pronë e juaja dhe do t'ju kthehen, me përjashtim të atyre që konsiderohen si të rrezikshme.



Do t'ju bëhen disa pyetje në lidhje me shëndetin tuaj dhe çdo dobësi për të parë nëse keni nevojë për ndonjë mbështetje të veçantë.



Do t'ju kërkohet të paraqisni të gjithë informacionin dhe të gjitha dokumentet e disponueshme për të mbështetur kërkesën tuaj. Këtu përfshihen informacione dhe dokumente në lidhje me:

- vendin tuaj të origjinës dhe çdo vend ku keni jetuar
- arsyet përse u larguat nga vendi juaj dhe përse nuk dëshironi të ktheheni
- historikun tuaj dhe të familjes suaj
- detajet e udhëtimit tuaj drejt dhe përmes Evropës
- kërkesat e mëparshme për mbrojtje ndërkombëtare.

Rendi i këtyre hapave mund të ndryshojë, por të gjithë kërkuesit trajtohen në të njëjtën mënyrë. Të dhënat e mbledhura do të ruhen në mënyrë të sigurt në bazat e të dhënave kombëtare dhe evropiane.

Është detyrimi juaj dhe është në interesin tuaj më të mirë të thoni të vërtetën dhe të bashkëpunoni me autoritetet.



Pas regjistrimit, do të merrni një dokument zyrtar që deklaron se kërkesa juaj është bërë dhe regjistruar. Pasi të keni paraqitur kërkesën tuaj, do të merrni një dokument zyrtar dixhital që deklaron se jeni aplikant për mbrojtje ndërkombëtare. Ky dokument quhet Kartë Aplikanti për Mbrojtje Ndërkombëtare dhe mund të ruhet në telefonin tuaj. Duhet ta mbani me vete gjatë gjithë kohës.

► CILA ËSHTË PROCEDURA NËSE KENI MBËRRITUR ME NJË FËMIJË OSE ME NJË TË RRRITUR NË VARËSI?



Nëse keni mbërritur me:

- fëmijët tuaj nën 18 vjeç, ose
- fëmijë nën moshën 18 vjeç për të cilët ju jeni ligjërisht përgjegjës

është e nevojshme që edhe ata të kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare. Fëmijët duhet të paraqiten me ju pranë autoriteteve.

Nëse fëmijët tuaj janë 18 vjeç e lart, ata duhet të depozitojnë vetë kërkesën e tyre.




Nëse jeni përgjegjës për një person 18 vjeç e lart që ka aftësi të kufizuara që e pengon të marrë vendime, ju mund të paraqisni kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare dhe ta depozitoni kërkesën në emër të tyre.

Personi duhet të jetë i pranishëm me ju gjatë depozitimit të kërkesës së tij.



➤ CILI SHTET DO TA SHQYRTOJË KËRKESËN TUAJ?



Ju garantohet se një shtet i BE+ do të shqyrtojë kërkesën tuaj për mbrojtje ndërkombëtare. Shteti nuk mund të zgjidhet nga ju.

Autoritetet do të ndjekin një procedurë për të vendosur se cili shtet i BE+ është përgjegjës për kërkesën tuaj për mbrojtje ndërkombëtare. Kjo procedurë quhet procedura e përcaktimit të përgjegjësisë.

Për këtë qëllim, do t'ju duhet t'i informoni autoritetet lidhur me sa më poshtë.

- Nëse keni anëtar familjeje në një shtet tjetër të BE+.
- Nëse një shtet tjetër i BE+ ju ka dhënë një vizë ose një dokument qëndrimi në të kaluarën. (Viza ju jep lejen për të vizituar një vend. Ajo mund të jetë në formën e një vule në pasaportën tuaj. Një dokument qëndrimi ju lejon të qëndroni në vend.)
- Nëse keni hyrë më parë në një shtet tjetër të BE+.
- Nëse keni paraqitur më parë një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në një shtet tjetër të BE+.
- Nëse një shtet tjetër i BE+ ju ka pajisur me një diplomë ose kualifikim arsimor.

Nëse autoritetet mendojnë se një shtet tjetër i BE+ mund të jetë përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj, ju do të merrni informacion më të detajuar mbi këtë procedurë dhe mbi të drejtat dhe detyrimet tuaja.

Do të mund të gjeni informacion të mëtejshëm në një broshurë të veçantë.

► SI DO TË SHQYRTOHET KËRKESA JUAJ?

SHQYRTIMI I PRANUESHMËRISË

Në disa situata, do të kryhet një shqyrtim paraprak i kërkesës suaj.

Ky shqyrtim paraprak quhet shqyrtim i pranueshmërisë dhe zgjat deri në 2 muaj.

Kjo do të thotë se autoritetet do të shqyrtojnë fillimisht gjashtë pyetjet e mëposhtme.

- A ju është dhënë më parë mbrojtje ndërkombëtare në një shtet tjetër të BE+?
- A ju është dhënë tashmë mbrojtje ndërkombëtare në një vend jashtë BE-së, ku do të jeni të sigurt dhe ku mund të ktheheni?
- A mund të ripranoheni në një vend ku jeni të sigurt dhe ku mund të shqyrtohet kërkesa juaj për mbrojtje ndërkombëtare?
- A keni kërkuar mbrojtje ndërkombëtare më shumë se 7 ditë pasi ju është dhënë një vendim kthimi?
- A ju ka siguruar një gjykatë ose tribunal ndërkombëtar penal zhvendosje të sigurt në një vend tjetër ose a janë duke e bërë këtë?
- A keni kërkuar përsëri mbrojtje ndërkombëtare, pas refuzimit të kërkesës suaj, pa paraqitur elemente të reja? Elementet e reja mund të jenë fakte ose prova të reja që sugjerojnë se ju keni nevojë për mbrojtje ndërkombëtare.



Ju mund të ftoheni në një intervistë që trajton këto pyetje. Kjo quhet **intervista e pranueshmërisë**. Gjatë kësaj interviste, mund t'ju pyesin edhe për arsyet përse keni kërkuar mbrojtje ndërkombëtare dhe përse nuk dëshironi të ktheheni në vendin tuaj.

Në varësi të rrethanave tuaja në lidhje me pyetjet e mësipërme:

- kërkesa juaj mund të refuzohet, ose
- procedura do të vazhdojë dhe autoritetet do të shqyrtojnë nëse keni nevojë për mbrojtje ndërkombëtare.

Stafi i Zyrës së Mbrojtjes Ndërkombëtare do t'ju informojë nëse shqyrtimi i pranueshmërisë vlen për ju dhe do t'ju japë shpjegime të mëtijshme.

➤ SI DO TË SHQYRTOHET KËRKESA JUAJ?

SHQYRTIMI I KËRKESËS SUAJ

Autoritetet do të shqyrtojnë nëse keni nevojë për mbrojtje ndërkombëtare.



Do të ftoheni në një **intervistë personale**.

Do ta merrni ftesën nëpërmjet llogarisë suaj elektronike në Portalin e Mbrojtjes Ndërkombëtare, ose me postë ose email, pas dorëzimit të aplikimit tuaj.

Intervista do të zhvillohet personalisht ose, në raste të jashtëzakonshme, nga distanca.

Intervista do të regjistrohet në audio.

Intervista është mundësia që ju të cilësoni me detaje arsyet për të cilat ju po kërkon mbrojtje ndërkombëtare dhe se përse nuk dëshironi të ktheheni në vendin tuaj të origjinës.

Ju duhet të merrni pjesë në intervistën personale dhe të mbërrini atje në kohë. Nëse nuk merrni pjesë në intervistën personale, pa pasur ndonjë arsye serioze dhe të justifikuar, kërkesa juaj do të konsiderohet e tërhequr dhe rasti juaj nuk do të shqyrtohet më. Nëse refuzoni t'u përgjigjeni pyetjeve gjatë intervistës pa pasur ndonjë arsye serioze, kërkesa juaj do të konsiderohet po ashtu e tërhequr.

Çdo azilkërkues i rritur do të intervistohet veçmas.

Pas intervistës personale, kërkesa juaj do të vlerësohet. Autoritetet do të vendosin nëse do t'ju jepet mbrojtje ndërkombëtare ose jo.

Në situata të jashtëzakonshme, intervista personale mund të mos zhvillohet. Autoritetet do t'ju informojnë nëse kjo vlen për rastin tuaj.

EKZAMINIMI MJEKËSOR



Autoritetet mund t'ju kërkojnë t'i nënshtroheni një ekzaminimi mjekësor në lidhje me shenja të persekutimit në të kaluarën ose të dëmtimeve serioze. Ekzaminimi është pa pagesë dhe do të kryhet vetëm me pëlqimin tuaj.

Ju do të informoheni në lidhje me rezultatet e ekzaminimit, të cilat do të merren parasysh në vlerësimin e kërkesës suaj. Nëse autoritetet nuk ju kërkojnë ekzaminim, ju mund të kërkonit ekzaminim me shpenzimet tuaja.

Një shqyrtim me kërkesën tuaj nuk e pengon autoritetin të vazhdojë me vendimin e tij.

JU DO TË PËRFITONI MBËSHTETJE TË VEÇANTË NËSE KENI NEVOJË

Ju duhet të informoni autoritetet sa më shpejt të jetë e mundur nëse keni nevojë për ndonjë mbështetje të veçantë. Këto nevoja mund të lindin nga një gamë e gjerë situatash, të tilla si shtatzënia, sëmundja ose përvojat e dhunës psikologjike, fizike ose seksuale.

Autoritetet do të vlerësojnë situatën tuaj dhe mund të ofrojnë mbështetje shtesë për të lehtësuar pjesëmarrjen tuaj në procedurën e azilit. Për shembull, ato mund të caktojnë staf të specializuar për rastin tuaj.



➤ SI DO T'JU JEPET VENDIMI LIDHUR ME KËRKESËN TUAJ PËR MBROJTJE NDËRKOMBËTARE?



Një vendim me shkrim do t'ju dërgohet nëpërmjet llogarisë suaj elektronike në Portalin e Mbrojtjes Ndërkombëtare, ose me postë ose email, juve ose këshilltarit tuaj ligjor, nëse keni një të tillë. Do të informoheni për rezultatin e vendimit në një gjuhë që e kuptoni.

Nëse vendimi është negativ, arsyet do të shpjegohen në vendim dhe do t'ju lëshohet një vendim për t'u kthyer në vendin tuaj..

MUNDËSIA PËR APELIM



Nëse nuk jeni dakord me vendimin, mund ta apelsoni atë. Kjo do të thotë që Tribunali për Apelime për Azilin dhe Kthimin (TARA) do ta shqyrtojë vendimin. Mund të kërkonti një këshilltar ligjor falas për t'ju ndihmuar të apelsoni.

Në procedurën kufitare të azilit, nuk lejoheni të qëndroni në vend gjatë procedurës së apelimit, përveç nëse autoritetet e lejojnë këtë.

Ju mund të bëni kërkesë që të lejoheni të qëndroni në prova të apelimit.

Ju duhet të paraqisni ankesën dhe të kërkonti për të qëndruar brenda afatit kohor të vendimit. Ju do të merrni informacion më të detajuar në lidhje me këtë nëse ju jepet një vendim negativ.

Nëse nuk keni të drejtë të mbështesni për arsye të tjera, do t'ju duhet të largoheni nga [...] brenda datës së cilësuar. Nëse nuk largoheni vullnetarisht, mund t'ju kthejnë në mënyrë të detyruar.

CILAT JANË TË DREJTAT TUAJA?

JU KENI TË DREJTËN TË PËRFITONI MBËSHTETJE DHE SHËRBIME PRITJEJE GJATË KOHËS QË PRISNI VENDIMIN MBI KËRKESËN TUAJ PËR MBROJTJE NDËRKOMBËTARE



Si kërkues, në parim ju keni të drejtën:

- të qëndroni në shtetin përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj, në një vend të caktuar në kufi, derisa të përfundojë shqyrtimi, dhe
- të përfitoni mbështetje dhe shërbime pritjeje.

Informacione në lidhje me mbështetjen dhe shërbimet e pritjes që do të përfitoni mund t'i gjeni në një broshurë të veçantë.



JU KENI TË DREJTËN E SHËRBIMEVE TË PËRKTHIMIT



Nëse nuk flisni anglisht, një përkthyes do t'ju ndihmojë të komunikoni me autoritetet gjatë regjistrimit dhe dorëzimit të aplikimit tuaj, si dhe gjatë intervistës suaj personale. Përkthyesi është pa pagesë.

Përkthyesi është asnjans, që do të thotë se nuk favorizon askënd. Ai respekton konfidencialitetin dhe nuk ndan asgjë nga ato që ju thoni me askënd përveç autoriteteve kompetente.

Përkthyesi nuk ka asnjë ndikim në vendimin lidhur me kërkesën tuaj.

Informoni menjëherë autoritetet nëse nuk e kuptoni përkthyesin apo nëse mendoni se ai nuk është asnjans.

KENI MUNDËSINË TË KËRKONI QË PËRKTHYESI DHE INTERVISTUESI PËR INTERVISTËN TUAJ PERSONALE TË JENË MASHKULL OSE FEMËR, NËSE KJO JU NDIHMON TË SHPREHENI LIRISHT



Në varësi të arsyeve që do të jepni dhe nëse ka disponueshmëri, kërkesa juaj do të plotësohet.

JU MUND TË KONSULTOHENI ME NJË KËSHILLTAR LIGJOR (AVOKAT)



Një këshilltar ligjor është një person që ju ofron ndihmë ose përfaqësim personal ligjor në marrëdhëniet me autoritetet. Këshilltari ligjor është i pavarur nga autoritetet dhe mbron interesat tuaja. Këshilltari ligjor mund t'ju ndihmojë me kërkesën tuaj për mbrojtje ndërkombëtare, me procedurën e azilit, me komunikim zyrtar dhe mund të qëndrojë me ju gjatë intervistës personale.

Është e drejta juaj të konsultoheni me një këshilltar ligjor në çdo fazë të procedurës së azilit me shpenzimet tuaja.

Bordi i Ndhmës Ligjore – Këshilla dhe Përfaqësim Ligjor

Ju mund të kërkonit një përfaqësues ligjor nga Bordi i Ndhmës Ligjore. Një përfaqësues ligjor do t'ju caktohet falas, i cili mund t'ju ofrojë këshilla ligjore para intervistave tuaja, me këshilla për çdo çështje që lind gjatë procesit.

Nëse merrni një vendim negativ dhe dëshironi të apelonit, përfaqësuesi ligjor do t'ju ndihmojë në paraqitjen e apelit tuaj, përgatitjen për apelin tuaj dhe do të marrë pjesë në seancën dëgjimore të apelit në emrin tuaj, ku ka një seancë dëgjimore me gojë.

Nëse preferoni të zgjidhni përfaqësuesin tuaj ligjor, ndani të dhënat e tij të kontaktit me autoritetet sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë që ata t'i mbajnë të informuar në lidhje me aplikimin tuaj.

JU KENI TË DREJTËN TË INFORMOHENI DHE TË KËRKONI KËSHILLIM LIGJOR FALAS



Ju mund të kërkonti këshillim ligjor, pa pagesë, gjatë procedurës së azilit. Këtu përfshihet këshillim ligjor për t'ju ndihmuar në depozitimin e kërkesës suaj.

Këshillimi ligjor nënkupton se mund të merrni shpjegime lidhur me:

- të drejtat dhe detyrimet tuaja
- procedurat e ndryshme
- problemet ligjore.

Mund të kërkonti informacion dhe këshillim ligjor në <https://www.legalaidboard.ie/>.

JU MUND TË KOMUNIKONI ME AGJENCINË E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR REFUGJATËT (UNHCR) OSE ME ORGANIZATA TË TJERA



Ju mund të kontaktoni dhe të komunikoni me UNHCR-në ose organizatat e saj partnere në çdo hap të procedurës së azilit.

UNHCR-ja mbron interesat dhe të drejtat e azilkërkuesve dhe refugjatëve. UNHCR-ja ose organizatat e saj partnere ofrojnë gjithashtu informacion dhe ndihmë për azilkërkuesit.

Detajet e kontaktit të UNHCR-së dhe informacioni mbi procedurën e azilit mund të gjenden në faqen e internetit të UNHCR-së <https://help.unhcr.org/>.

Ju mund të kontaktoni po ashtu çdo organizatë tjetër që ofron këshillim ligjor ose këshillim tjetër për kërkuesit.

CILAT JANË DETYRIMET TUAJA?

RESPEKTONI LIGJET E VENDIT



QËNDRONI NË VENDIN KU KENI PARAQITUR KËRKESË PËR MBROJTJE NDËRKOMBËTARE



Mos u përpiqni të shkoni në një vend tjetër të BE+ ose në Mbretërinë e Bashkuar (përfshirë Irlandën e Veriut).

Mos u largoni nga vendi specifik ku ju është thënë të banoni.

Ju lejohet të udhëtoni në një vend tjetër të BE+ vetëm nëse ju jepet leje nga autoritetet.

SIGUROHUNI QË AUTORITETET TË MUND T'JU KONTAKTOJNË DHE QË T'I NDIQNI TAKIMET TUAJA



Ju duhet të merrni pjesë në të gjitha takimet, duke u paraqitur personalisht, sa herë që ju kërkohet nga autoritetet. Duhet të jeni atje në kohë. Nëse nuk jeni në gjendje të merrni pjesë në një takim për një arsye serioze, informoni menjëherë autoritetet dhe shpjegoni arsyen.

BASHKËPUNONI PLOTËSISHT ME AUTORITETET



Kur kërkohet, ju duhet të bëni sa më poshtë.

- Të jepni të dhënat tuaja personale.



- Të jepni dokumentet e identitetit. Nëse nuk i dispononi, shpjegoni arsyen përse.



- T'i nënshtroheni procesit të marrjes së gjurmëve të gishtërinjve dhe fotografimit.



- Të depozitoni kërkesën tuaj në një datë dhe vendndodhje të caktuar.
- Të merrni pjesë në intervistën personale dhe t'u përgjigjeni pyetjeve gjatë intervistës.



- Të pranoni t'i nënshtroheni kontrollit fizik dhe të sendeve vetjake, nëse autorite ju kërkojnë ta bëni këtë. Kontrollat do të kryhen vetëm kur është e nevojshme dhe e justifikuar. Autoriteti do t'ju shpjegojë arsyet e kontrollit. Kontrolli do të kryhet nga një person i së njëjtës gjini si ju dhe do të bëhet në një mënyrë që respekton dinjitetin tuaj.

TREGONI TË VËRTETËN



Ajo që thoni është shumë e rëndësishme për besueshmërinë e kërkesës suaj. Kjo është arsyeja se përse ju duhet të jeni të sqartë dhe të jepni informacion të plotë dhe të saktë në lidhje me identitetin tuaj, familjen, vendin e origjinës, arsyet përse jeni larguar nga vendi juaj i lindjes dhe përse nuk dëshironi të ktheheni atje.

Mund të mos mbani mend gjithçka dhe mund të mos jeni në gjendje t'u përgjigjeni të gjitha pyetjeve. Nëse është kështu, shpjegoni se nuk mbani mend dhe mos jepni përgjigje të menduara aty për aty.

JEPNI TË DHËNA TË SAKTA KONTAKTI DHE SIGUROHUNI QË TË MUND T'JU KONTAKTOJNË



Autoritetet duhet të jenë në gjendje t'ju kontaktojnë në lidhje me kërkesën tuaj për mbrojtje ndërkombëtare.

Nëse adresa juaj, emaili ose numri i telefonit ndryshojnë, informoni menjëherë autoritetet.

DORËZONI TË GJITHA INFORMACIONET DHE DOKUMENTET QË MBËSHTETIN APLIKIMIN TUAJ NË ZYRËN E MBROJTJES NDËRKOMBËTARE

Nëse keni dokumente identiteti, duhet t'i paraqisni ato sa më shpejt që të jetë e mundur.

Ju duhet të paraqisni çdo informacion dhe dokument tjetër që mund t'i ndihmojë autoritetet të vendosin shtetin përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës suaj ose për të shqyrtuar kërkesën tuaj. Këto dokumente mund të jenë, për shembull, një pasaportë, certifikatë martese, regjistri i gjendjes familjare, letërnjoftim ushtarak, dëshmi punësimi, kartë anëtarësie e një partie politike, certifikata, raporte gjyqësore dhe policore, fotografi dhe dokumentacion mjekësor ose psikologjik.

Ju nuk keni nevojë të paraqisni dokumente që përmbajnë vetëm informacion të përgjithshëm në lidhje me vendin tuaj. Autoritetet e azilit janë në dijeni të situatës në vendin tuaj.



Ju duhet të dorëzoni të gjithë informacionin dhe dokumentet sa më shpejt të jetë e mundur kur paraqisni kërkesën tuaj. Nëse nuk i keni dokumentet menjëherë në dispozicion, duhet t'i dorëzoni ato sapo t'i keni, nëpërmjet llogarisë suaj elektronike në Portalin e Mbrotjtjes Ndërkombëtare ose me email në info@ipo.gov.ie.


Kurdoherë që është e mundur, duhet të paraqisni dokumentet origjinale. Nuk duhet të shkatërroni ose asgjësoni asnjë dokument identiteti. Nuk duhet të fshihni asnjë dokument me rëndësi. Nuk duhet të dorëzoni asnjëherë dokumente të rreme ose të falsifikuara.

Nëse është e mundur dhe në masën që nuk përbën rrezik, kërkoni nga miqtë ose të afërmit që t'ju dërgojnë dokumentet tuaja.



CILAT JANË PASOJAT NËSE NUK I PËRMBUSHNI DETYRIMET TUAJA?

PROCEDURA JUAJ E AZILIT DO TË NDËRPRITET



Kjo do të ndodhë nëse refuzoni:

- të jepni informacion kur ju kërkohet ta bëni këtë gjë
- t'i nënshtroheni procesit të marrjes së gjurmëve të gishtërinjve dhe fotografimit
- të jepni adresën tuaj
- t'u përgjigjeni pyetjeve gjatë intervistës suaj personale.

Kjo do të ndodhë edhe nëse ju:

- nuk e depozitoni kërkesën tuaj brenda afatit të caktuar kohor, pa pasur ndonjë arsye serioze
- nuk merrni pjesë në intervistën personale, pa pasur ndonjë arsye serioze
- nuk raportoni tek autoritetet kur ju kërkohet
- nuk qëndroni në vendin ku jeni të detyruar të qëndroni
- nuk mund të kontaktoheni nga autoritetet
- largoheni nga vendi.

Kërkesa juaj do të konsiderohet e **tërhequr ose e refuzuar**.

Kjo do të thotë se ju mund të humbni statusin tuaj si kërkues për mbrojtje ndërkombëtare dhe të gjitha të drejtat e lidhura me të.

Gjithashtu, ju mund të vendosni ta tërhiqni kërkesën tuaj në çdo kohë gjatë procedurës së azilit, për shembull, sepse keni vendosur të ktheheni në vendin tuaj. Në këtë rast, ju do të humbisni statusin tuaj si kërkues për mbrojtje ndërkombëtare.

DISA LLOJE TË MBËSHTETJES DHE SHËRBIMEVE TË PRITJES MUND TË REDUKTOHEN OSE TË ANULOHEN



Në disa rrethana, autoritetet mund të vendosin të zvogëlojnë ose anulojnë një lloj mbështetjeje ose disa shërbime. Autoritetet do t'ju informojnë me shkrim për një vendim të tillë pasi të vlerësojnë situatën tuaj.

Mund të gjeni më shumë informacion në një broshurë të veçantë.

KËRKESA JUAJ MUND TË NDIKOHET NEGATIVISHT



Nëse jepni informacion keqorientues ose të rremë në lidhje me identitetin ose kërkesën tuaj, ose nëse shkatërmoni apo falsifikoni dokumente, kjo mund të ndikojë negativisht në kërkesën tuaj. Kërkesa juaj mund të refuzohet dhe mund të mos përfitoni mbrojtje ndërkombëtare.

Nëse autoritetet zbulojnë më vonë se nuk keni thënë të vërtetën gjatë procedurës së azilit, mund t'ju hiqet edhe mbrojtja ndërkombëtare.

PO NËSE DËSHIRONI TË KTHEHENI NË VENDIN TUAJ?

Në çdo kohë gjatë procedurës së azilit, mund të vendosni të ktheheni vullnetarisht në:

vendin tuaj ose

një vend tranziti ose një vend tjetër të tretë, nëse keni të drejtë ta bëni këtë.

Mund të merrni ndihmë me fluturimet, dokumentet e udhëtimit dhe rregullimet e udhëtimit. Mund të merrni edhe mbështetje financiare, në varësi të kriterëve të përfitimit.

Nëse vendosni të ktheheni vullnetarisht, procedura juaj e azilit do të ndalet ose do të refuzohet dhe nuk do të keni më të drejtë të qëndroni në Irlandë.

Nëse dëshironi të ktheheni vullnetarisht, kontaktoni Njësinë e Kthimeve Vullnetare në Qendrën e Pritjes Citywest me email në voluntaryreturns@justice.ie ose me telefon në +353 87 403 1651. Mund të merrni informacion, si dhe ndihmë për kthimin tuaj të sigurt dhe të ligjshëm.





KONFIRMIMI I MARRJES SË INFORMACIONIT

Do t'ju kërkohet të konfirmoni që keni marrë informacionin në këtë broshurë nëpërmjet llogarisë suaj elektronike në Portalin e Mbrojtjes Ndërkombëtare.

Nëse nuk keni kuptuar diçka ose nëse keni pyetje shtesë, gjithmonë mund t'i drejtoheni stafit në Qendrën tuaj të Akomodimit.



An Roinn Dlí agus Cirt,
Gnóthaí Baile agus Imirce
Department of Justice,
Home Affairs and Migration

Kjo broshurë është vetëm për qëllime informuese. Ajo nuk krijon në vetvete të drejta apo detyrime. Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin (EUAA) ka siguruar strukturën kryesore të këtij materiali dhe riprodhimi dhe ndryshimi i kësaj broshure autorizohet nga EUAA-ja vetëm për shtetet anëtare të BE-së. EUAA-ja nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi apo detyrim për saktësinë, përmbajtjen, plotësinë, ligjshmërinë ose besueshmërinë e informacionit të përfshirë në këtë faqe nga shtetet anëtare të BE-së ose nga ndonjë palë tjetër e tretë përgjegjëse. EUAA-ja dhe çdokush që vepron në emër të EUAA-së nuk mbajnë përgjegjësi për përdorimin që mund t'u bëhet informacioneve që përmban kjo broshurë.